



SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 2 prill 2026, ora 10:00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr. 21, datë 31.3.2026 të Kryetarit të Kuvendit, z. Niko Peleshi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 30.3.2026.
(Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime.
(Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Besfort Lamallari, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.**
(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit)
4. **Interpelancë me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, kërkuar nga deputetja Jorida Tabaku.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 96 të Rregullores së Kuvendit)*
5. **Seancë pyetje – përgjigje me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Besfort Lamallari, kërkuar nga deputeti Arian Ndoja.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe neneve 90 - 95 të Rregullores së Kuvendit)*
6. **Seancë pyetje – përgjigje me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Besfort Lamallari, kërkuar nga deputeti Erald Kapri.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe neneve 90 - 95 të Rregullores së Kuvendit)*

7. **Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare, bërë në Singapor, më 27 mars 2006”.** *(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Dhënie mendimi Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm

Dhënie mendimi Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme

Dhënie mendimi Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

8. **Projektligji “Për ratifikimin e vendimit nr. 1/2025 të Komitetit të Përbashkët, i krijuar nga marrëveshja e tregtisë së lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, duke zëvendësuar protokollin II të saj, në lidhje me përcaktimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ”.** *(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Dhënie mendimi Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme

Dhënie mendimi Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

9. **Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobit për Mbrojtjen e Simbolit Olimpik, bërë në Najrobi, më 26 shtator 1981”.** *(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin, Shkencën dhe Sportet

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Dhënie mendimi Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

- 10. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin parqeve teknologjike dhe shkencore””. (Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)**

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

- 11. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, datë 17.06.2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, të ndryshuar”.**

(Në mbështetje të neneve 78 dhe 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 38, 55, 68, 73 dhe 74 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Dhënie mendimi Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit në parim

- 12. Projektvendimi “Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës”.**

(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

- 13. Projektvendimi “Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.**

(Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

14. Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 61/2025, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

(Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 22 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

15. Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 64/2025, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

(Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

16. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)